



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

**PA1 Nr.08-275**

**21.10.2024**

**Shkup**

Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 1 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10<sup>1</sup> të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 69 paragrafët (1) dhe (4), neni 70 paragrafët 1, 4, 6, 9, 10, 11 dhe 12, neni 71, neni 74, neni 79, neni 80 dhe neni 81 nga Ligji i njëjtë, neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 1, neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 10 dhe neni 51 paragrafi (1) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.07.2019, dhe në lidhje me Letrën me qëllim të dhënies së lejes për transmetim në radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës nga i interesuari, personi fizik Sasha Mitiq nga Kumanova (nr.y në ark.08-2944/1) datë 04.07.2024), Njoftimin nga Agjencia për Komunikime Elektronike, ark.nr.0805-1989/2 datë 15.07.2024 (nr.y në ark.08-2944/4 datë 17.07.2024), Studimin për përcaktimin e arsyesimit për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës (ark.nr.03-4117/1 datë 04.10.2024 ) dhe Konkluzionin ark.nr.02-4253/3 datë 18.10.2024, në seancën e 39-të mbajtur më 17.10.2024, miratoi si vijon:

**VENDIM**

**për shpallje të konkursit publik për dhënien e  
lejes për transmetim në radio të shërbimit programor  
në nivel lokal**

1. Shpallet konkursi publik për dhënien e 1 (një) leje për transmetim në radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës, dhe atë për shërbim programor radio folëse-muzikore me format të përgjithshëm në të cilin llojet e programeve të përfaqësuara realizojnë së paku dy nga tre funksionet mediatike, në gjuhën maqedonase, që do të transmetohen përmes radio frekuencës të përcaktuar nga Agjencia për Komunikime Elektronike (AKE), dhe atë: 92.6 MHz.

2. Leja do të jipet për një periudhë 9 (nëntë) vjeçare dhe nuk mund t'i transferohet një personi tjetër.

3. Kandidatët e konkursit duhet të përmbushin kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike, përcaktuar në Rregulloren për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3953/1 datë 31.10.2023, të cilat shpjegohen dhe specifikohen në Dokumentacionin e konkursit.

4. Karakteristikat teknike dhe parametrat e përcaktuar nga AKE në pajtim me Ligjin për Komunikime Elektronike ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr.39/14, 188/14, 44/15, 193/15, 11/18 dhe 21/18 dhe "Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr.98/19, 153/19 dhe 92/21 ) dhe dispozitat miratuar në

---

<sup>1</sup> Nënparagrafët 8 dhe 9 janë fshirë, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr.248/18).

bazë të ligjit, shpjegohen dhe specifikohen në Dokumentacionin e konkursit dhe miratimin për shfrytëzimin e radiofrekuencave të dhënë nga AKE.

5. Aplikimet e paraqitura në konkurs, Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) do t'i vlerësojë në bazë të kriterëve të mëposhtme, sipas metodës së pikëzimit në vijim:

<b>1. Përfaqësimi i programit të prodhuar nga vetë transmetues (in-house production), gjatë javës</b>		<b>17 pikë</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>deri në 50% të pjesës folëse të programit</li> </ul>	10 pikë	
<ul style="list-style-type: none"> <li>mbi 50% të pjesës folëse të programit</li> </ul>	17 pikë	
<b>2. Cilësia, zhanri dhe diversiteti tematik i përmbajtjeve</b>		<b>17 pikë</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>nga 3 deri në 5 lloje programesh në pjesën folëse të programit</li> </ul>	10 pikë	
<ul style="list-style-type: none"> <li>mbi 5 lloje programesh në pjesën folëse të programit</li> </ul>	17 pikë	
<b>3. Përfaqësimi në programe që nxisin zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës kombëtare</b>		<b>17 pikë</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li><b>programe që nxisin zhvillimin dhe ruajtjen e kulturës kombëtare, të transmetuara çdo vit</b></li> </ul>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>deri në 15 orë gjatë vitit</li> </ul>	5 pikë	
<ul style="list-style-type: none"> <li>mbi 15 orë gjatë vitit</li> </ul>	9 pikë	
<ul style="list-style-type: none"> <li><b>muzikë instrumentale nga autorë maqedonas, dhe muzikë vokale dhe/ose vokalo-instrumentale në gjuhën maqedonase e transmetuar gjatë ditës</b></li> </ul>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>deri në 30% nga totali i muzikës së transmetuar</li> </ul>	5 pikë	
<ul style="list-style-type: none"> <li>mbi 30% nga totali i muzikës së transmetuar</li> </ul>	8 pikë	
<b>4. Përfaqësimi i informacionit dhe përmbajtjes në pjesën folëse të programit me rëndësi për zonën në të cilën do të transmetohet shërbimi programor (informacion me karakter lokal), gjatë javës</b>		<b>10 pikë</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>nga 3 deri në 5 të pjesës folëse të programit</li> </ul>	5 pikë	
<ul style="list-style-type: none"> <li>mbi 5 orë të pjesës folëse të programit</li> </ul>	10 pikë	

<b>5. Numri dhe struktura e të punësuarve të nevojshëm për kryerjen e veprimtarisë (së paku 2 (dy) persona pjesëmarrës në krijimin e programit, të punësuar në marrëdhënie të rregullt pune me kohë të plotë)</b>		<b>7 pikë</b>
• <b>2 të punësuar</b>	5 pikë	
• <b>mbi 2 të punësuar</b>	7 pikë	
<b>6. Kushtet teknike për prodhimin e programeve</b>		<b>7 pikë</b>
<b>7. Koha e ofruar e programit të transmetuar ditor</b>		<b>7 pikë</b>
• nga ora 10 deri në orën 17	4 pikë	
• mbi 17 orë	7 pikë	
<b>8. Kushtet hapësinore për kryerjen e veprimtarisë</b>		<b>7 pikë</b>
<b>9. Garancit e ofruara për aftësinë financiare për realizimin e veprimtarisë</b>		<b>7 pikë</b>
<b>10. Afati i ofruar për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë</b>		<b>4 pikë</b>
• <b>deri në 3 muaj nga dita e dhënies së lejes</b>	4 pikë	
• <b>mbi 3 muaj nga dita e dhënies së lejes</b>	2 pikë	
	<b>Në total</b>	<b>100 pikë</b>

6. Për lejen për transmetim në radio paguhet (tarif)kompensim vjetor për çdo vit aktual, duke filluar nga data e dhënies së lejes, në llogari të Agjencisë, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia.

Mënyra e llogaritjes, faturimit dhe pagesës së kompensimit për leje, përcaktohet nga Agjencia në pajtim me nenin 80 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) dhe në pajtim me Rregulloren për procedurat e punës financiare dhe kontabël të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 185/14), Rregulloren për formatet e shërbimeve programore të transmetuesve ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr.172/14) dhe Rregulloren për zonat e transmetimit të shërbimeve programore televizive dhe radio ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr.172/14).

7. Për shfrytëzimin e radiofrekuencave paguhet kompensim vjetor në pajtim me Ligjin për komunikime elektronike dhe Rregulloren për mënyrën e llogaritjes së kompensimit vjetor për shfrytëzimin e radiofrekuencave të AKE-së ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr.192/21).

Kompensimi për shfrytëzimin e radiofrekuencave paguhet në llogari të AKE për çdo vit aktual paraprakisht duke filluar nga data e vlefshmërisë së miratimit për shfrytëzimin e radiofrekuencave.

8. Për të përcaktuar frekuencën e transmetimit, mikrolokacionin, fuqinë maksimale efektive të rrezatuar (EPR), drejtimi i sistemit të antenës, si dhe parametra të tjerë teknikë që nuk përcaktohen nga ky Vendim dhe dokumentacioni i konkursit, kandidatët janë të detyruar (pas marrjes së dokumentacionit nga Agjencia dhe marrjes së konfirmimit nga Agjencia për dokumentacionin e marrë) t'i drejtohen AKE ku do të marrin parametrat e detajuar teknikë, si pjesë përbërëse e dokumentacionit të konkursit dhe sipas të cilës do të duhet të përgatitet raporti teknik për pjesën e transmetimit.

Aplikimi i kandidatëve në AKE duhet të ketë të njëjtin titull si në Agjencion.

9. Kandidatët në konkurs paraqesin aplikimet në formular të veçantë, formën dhe përmbajtjen e të cilit e përcakton Agjencia, i cili publikohet në ueb-faqen e Agjencisë.

Dokumentacioni i konkursit dhe formulari-Aplikimi për pjesëmarrjen në konkursin publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës do të merren në arkivin e Agjencisë, Pallati "Panko Brashnarov", rr."Makedonija " nr.38, Shkup çdo ditë pune nga ora 8:00 deri në orën 16:00.

Për dokumentacionin paguhet kompensim(tarifë) në shumë prej 60.000,00 (gjashtëdhjetë mijë) denarë në xhiro llogari: 300000000618023 të Agjencisë, Banka depozitues: Komercijalna banka SHA Shkup.

10. Aplikimi paraqet në zarf të mbyllur drejtuar Agjencisë, Pallati "Panko Brashnarov", rr."Makedonija" nr.38, Shkup, e shënuar si në vijim<sup>2</sup>, përkatësisht:

- në këndin e sipër majtas të zarfit të mbyllur të shënohet "MOS E HAP" ,
- në mesin e zarfit të mbyllur të shënohet "Aplikim për pjesëmarrje në konkurs publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës".

Format dhe Shtojcat ndaj Aplikimit për pjesëmarrje në konkursin publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës, duhet të sistemohen sipas radhës, domethënë shtojcë ndaj aplikimit, me çdo shtojcë të aplikimit, në faqen e parë të këndit të sipërm djathtas të fletës, duhet të shënohet numri vijues përkatës ( Shembull: Shtojcë nr. \_\_\_\_).

Aplikimi, me dokumentacionin shoqërues nga neni 73 paragrafi (3) të LSHMAAV, dorëzohet në 2 ( dy ) kopje ( origjinale dhe kopje ).

11. Aplikacioni mund të dërgohet me postë rekomanduese ose me dorëzim në arkivin e Agjencisë.

12. Aplikimi dorëzohet në afat prej 60 ( gjashtëdhjetë ) ditësh.

Afati për dorëzimin e aplikacioneve fillon nga dita e parë pas publikimit të këtij Vendimi në "Gazetën Zyrtare të RMV-së".

Aplikimet paraqiten në afatin e përcaktuar me këtë Vendim në mënyrën, formën, numër të kopjeve dhe përmbajtjen e parashikuar në dokumentacionin e konkursit.

Aplikimet e kandidatëve që nuk do të paguajnë kompensimin e dokumentacionit, që do të dorëzohen pas skadimit të afatit përcaktuar me këtë Vendim, aplikimet e pa kompletura ( që nuk do t'i përmbajnë të gjitha dokumentet dhe shtojca në pajtim me Aplikimin ), aplikimet e plotësuar në mënyrë të parregullt, si dhe aplikimet që nuk do të dorëzohen në 2 ( dy ) kopje (origjinale dhe kopje ), nuk do të shqyrtohen.

Informacion shtesë, në lidhje me konkursin e shpallur publik, mund të merren nga personat në vijim:

- për konceptin programor: mr. Ognen Nedelkovski telefon celular: 072/212-686 dhe e-mail adresë: [o.nedelkovski@avmu.mk](mailto:o.nedelkovski@avmu.mk); Nesrin Mahmut telefon celular: 075/452-531 dhe e-mail adresë: [n.sejfula@avmu.mk](mailto:n.sejfula@avmu.mk);

---

<sup>2</sup> Nëse parashtruesit e aplikimeve për pjesëmarrje në konkurs publik nuk i përmbushin kushtet e përcaktuara në pikën 10 të këtij vendimi, Agjencia nuk merr përgjegjësi për vonesën ose hapjen e parakohshme të Aplikimit.

- për strukturën e pronësisë dhe kushtet kadrovike: Katerina Donevska telefon celular: 075/452-543 dhe e-mail adresë: [k.mitre@avmu.mk](mailto:k.mitre@avmu.mk) ;
- për kushtet teknike dhe hapësinore: mr. Argjend Xhelili telefon celular: 070/327-991 dhe e-mail adresë: [argjend.xhelili@avmu.mk](mailto:argjend.xhelili@avmu.mk);
- për kushtet financiare: Goran Radunoviq telefon celular : 071/223-219 dhe e-mail adresë: [g.radunovic@avmu.mk](mailto:g.radunovic@avmu.mk); Vesna Simonovska telefon celular: 076/ 344-198 dhe e-mail adresë: [v.simonovska@avmu.mk](mailto:v.simonovska@avmu.mk) dhe
- për të dhëna të përgjithshme dhe çështje juridike: mr. Ivona Mufisheva telefon celular: 076/496-803 dhe e-mail adresë: [i.mufiseva@avmu.mk](mailto:i.mufiseva@avmu.mk) dhe mr.Biljana Paneva-Parleeva telefon celular: 076/344-194 dhe e-mail adresë: [b.parleeva@avmu.mk](mailto:b.parleeva@avmu.mk) .

13. Aplikimet që do të dorëzohen në konkursin publik, do të hapen publikisht, në selinë e Agjencisë, Pallati "Panko Brashnarov", rr. "Makedonija" nr.38, Shkup, një javë pas skadimit të afatit për paraqitjen e aplikimeve, përcaktuar në pikën 12 të këtij vendimi.

Informacioni për ditën dhe orën e hapjes publike do të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë: [www.avmu.mk](http://www.avmu.mk).

14. Vendimi për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës, në gjuhën maqedonase, do të miratohet në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e hapjes publike të aplikimeve, e cekur në pikën 13 të këtij vendimi.

Kandidatët e konkursit do të njoftohen për vendimin për dhënien e lejes, në afat prej 7 (shtatë ) ditësh nga dita e miratimit.

15. Ky vendim botohet në "Gazetën Zyrtare të RMV-së", në ueb-faqen e Agjencisë, si dhe së paku në 2 (dy) gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarët të RMV-së, dhe hyn në fuqi nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të PMV-së".

## A r s y e t i m

Drejtuar Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia), në adresën zyrtare elektronike e-mail ( [contact@avmu.mk](mailto:contact@avmu.mk) ) më 04.07.2024, është dorëzuar Letër qëllimi, nr.y në ark.08-2944/1 datë 04.07.2024 nga i interesuari, personi fizik Sasha Mitiq nga Kumanova, për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal në zonën e komunës së Kumanovës.

Agjencia, në pajtim me nenin 70 paragrafi (4) të LSHMAAV, me datë 09.07.2024 me rastin e letrës në fjalë ka dërguar Shkresë - Kërkesë, nr.y në ark.08-2944/2 drejtua AKE me të cilën ka kërkuar informacion nëse ka frekuencë të lirë në zonën e qytetit të Kumanovës, dhe nëse ka-dhe informacion për parametrat bazë teknik në bazë të të cilave do të hartohet një zgjidhje teknike për transmetim të programit në radio. Njëkohësisht, Agjencia me datë 11.07.2024, drejtuar palës së interesuar personit fizik Sasha Mitiq nga Kumanova i ka dorëzuar Njoftim, nr.y në ark.08-2944/3 datë 11.07.2024, për veprimet e ndërmarra nga Agjencia me rastin e letrës në fjalë, si dhe shpjegim për procedurën e paraparë në LSHMAAV për dhënien e lejes për transmetim në radio, njoftim për të cilin ishte marrë me datë 15.07.2024. .

Me datë 17.07.2024 AKE drejtuar Agjencisë dorëzoi Njoftim në lidhje me kërkesën për informacion për frekuenca të lira për transmetim të programit në radio në nivel lokal për qytetin e Kumanovës, ark. nr.0805-1989/2 datë 15.07.2024 (nr.y në ark.08-2944/4 datë 17.07.2024), se mbi bazën e shpërndarjeve (alokimeve) ekzistuese, analizave të shtrirjes së radios dhe matjeve në rajonin e qytetit të Kumanovës, parametrat bazë teknike sipas të cilave duhet të hartohet zgjidhje teknike për mbulimin e qytetit të Kumanovës janë: Vendndodhja e transmetuesit: Stari Lozja, Fuqia efektive e rrezatuar: 200 W dhe Frekuenca: 92.6 MHz.

Neni 70 paragrafi (4) të LSHMAAV parasheh se nëse në pajtim me Planin për ndarjen dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave konstatohet se ekzistojnë radio frekuenca të lira, Agjencia do të

përgatisë studim që do të përcaktojë arsyetimin për shpallje të konkursit publik sidomos nga aspekti i përmbushjes së qëllimit të këtij ligji, si dhe në aspektin e nevojave të publikut.

Si rezultat i kësaj, Agjencia ka përgatitur studim për të përcaktuar arsyetimin për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës (ark.nr.03-4117/1 datë 04.10.2024), i cili është publikuar në ueb-faqen e Agjencisë më 04.10.2024<sup>3</sup>. Studimi është përgatitur për të përcaktuar arsyetimin për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për radio lokale në zonën e komunës së Kumanovës, si nga aspekti i përmbushjes së qëllimit të LSHMAAV ashtu edhe nga aspekti i nevojave të publikut. Kumanova është komunë me më shumë banorë në Maqedoni, dhe në të njëjtën kohë potenciali ekonomik i kësaj komune është i konsiderueshëm (më shumë subjekte afariste ka vetëm në Manastir dhe Tetovë). Leje për transmetim të programit në radio në Kumanovë kanë vetëm dy radiostacione (nga ku pjesën folëse njëra e transmeton në gjuhën maqedonase dhe serbe dhe tjetra në gjuhën shqipe). Analiza e performancës ekonomike të këtyre dy radiostacioneve tregoi se potenciali real i tregut të kësaj komune nuk shfrytëzohet në mënyrë optimale. Me dhënien e lejes së re nuk do të rrezikohet cilësia e ofertës programore ekzistuese, por do të pasurohet dhe publiku do të marrë përmbajtje të reja me karakter lokal dhe informacione për zhvillimet në kuadër të komunës. Gjetjet e këtij studimi treguan se ka arsyetim për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio në nivel lokal, në zonën e Komunës së Kumanovës, dhe atë për shërbim programor me fjalë-radio muzikore me format të përgjithshëm në të cilin llojet e programeve të përfaqësuara realizojnë së paku dy nga tri funksionet mediatike, në gjuhën maqedonase.

Rrjedhimisht, gjithçka që u shpjegua më lartë, dhe duke pasur parasysh se në pajtim me Planin për dhënien dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave, është përcaktuar se ka radiofrekuencë të lirë për komunën e Kumanovës, dhe në pajtim me Studimin, ark.nr.03-4117/1 datë 04.10.2024, përcaktohet arsyetimi për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 1 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 69 paragrafët (1) dhe (4), neni 70 paragrafët 1, 4, 6, 9, 10, 11 dhe 12, neni 71, neni 74, neni 79, neni 80 dhe neni 81 nga Ligji i njëjtë, neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 1, neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 10 dhe neni 51 paragrafi (1) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Konkluzionin ark.nr.02-4253/3 datë 18.10.2024, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale në seancën e 39-të mbajtur më 17.10.2024, miratoi Vendim si në dispozitiv, i cili do të botohet në "Gazetën Zyrtare të RMV-së", në ueb-faqen e Agjencisë, si dhe së paku në 2 (dy) gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarët të RMV-së, dhe hyn në fuqi nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të RMV-së".

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI**

---

<sup>3</sup><https://avmu.mk/wp-content/uploads/2024/10/Studim-për-përcaktimin-e-arsyetimit-për-shpallje-konkurs-publik-për-dhënien-leje-për-radio-lokale-në-Kumanovë.pdf>